 - c) mostra nuk kerkohet sic percaktohet ne piken 304

1.17.4 Testimi

- (1) Pervecse ne rastet kur deklarohet ndryshe ne Kontrate, testet laboratorike do te kryhen nga Kontraktori ne labororet e akredituar nga Qeveria Shqiptare per testet perkatese qe do perdoren, nese jane te disponueshme, perndryshe te dhena per laboratorin e propozuar duhet t'i dorezohen Supervizorit per miratim.
- (2) Pervecse ne rastet kur deklarohet ndryshe ne Kontrate ose instruktohet nga Supervizori, testet in situ (ne vend) duhet te kryhen nga Kontraktori ne prezencen e Supervizorit.
- (3) Pervecse ne rastet kur deklarohet ndryshe ne Kontrate, pajisjet, aparatet dhe materialet per testet in situ (vend) dhe testet e perputhshmerise laboratorike te kryera nga Kontraktori duhet te sigurohen prej tij. Pajisjet dhe aparatet duhet te mirembahen nga Kontraktori dhe duhet te kalibrohen perpara se te filloje testi dhe ne intervale te rregullta te miratuara nga Supervizori. Pajisjet, aparatet dhe materialet per testet in situ duhet te hiqen nga Kontraktori sa me shpejt te jete e mundur pasi te kete mbaruar testi..
- (4) Kontraktori do te kete te drejte te asistojte ne testet dhe punet qe kryhen ne labororet e Punedhenesit dhe te inspektojte te dhenat perkatese.

1.17.5 Perputhshmeria e nje grumbulli

- (1) Pervecse ne rastet kur deklarohet ndryshe ne Kontrate, rezultatet e testeve ne mostra dhe specie duhet te konsiderohen sikur prezantojne teresine e grumbullit prej te cilit eshte marre mostra.
- (2) Nje grumbull duhet te konsiderohet qe perputhet me kerkesat specifike per materialin nese rezultatet e testeve specifike per veti te specifikuara perputhen me kerkesat specifike per vetite.
- (3) Nese lejohen teste shtese dhe kriteri i perputhshmerise per testet shtese nuk jane deklaruar ne kontrate, Supervizori duhet te percaktojte nese grumbulli -(batch-i) perputhet me kerkesat specifike per materialin mbi bazen e rezultateve te gjitha testeve, duke perfshire dhe testet shtese, per cdo prone.

1.17.6 Te dhenat e testeve

- (1) Te dhena te testeve in situ (vend) dhe perputhshmeria e testeve laboratorike te kryera nga Kontraktori duhet te mbahen nga ky I fundit ne vendin e punes, dhe nje raport duhet t'i dorezohet Supervizorit brenda 7 diteve, ose brenda nje kohe te deklaruar ne Kontrate, pas mbarimit te cdo testi. Raporti duhet te kete detajet si me poshte:
 - a) material ose pjese nga puna e testuar
 - b) lokalizim i grumbullit nga i cili jane marre mostra ose lokalizim i pjeses se punes,,
 - c) vendi i testit,
 - d) data dhe koha e testeve,
 - e) kushtet e motit ne rast se jane marre testet in situ.
 - f) Supervizim teknik i personelit dhe kryerja e testeve,,
 - g) madhesia dhe pershkrimi i mostrave,
 - h) metodat e mostrave,
 - i) vetite e testuara,
 - j) metoda e testit,
 - k) leximi dhe masat e marra gjate testeve,

- l) rezultatet e testeve, duke përfshirë cdo llogaritje dhe grafike, dhe
- m) detaje të tjera të deklaruara në kontratë.

- (2) Raporte të testit duhet të nënshkruhen nga agjenti i Kontraktorit ose nga një përfaqësues tjetër i autorizuar me shkrim nga Kontraktori.
- (3) Të dhënat e testeve të kryera nga stafi i Punedhënesit ose nga Supervizori do t'i jepen Kontraktorit sipas kërkesës.

1.18 Mjeshteria e punës dhe tolerancat

1.18.1 Puna e krahut

Puna e krahut duhet të përputhet me praktiken më të mirë të tregut dhe me Standartet përkatëse Europiane ose Standartet Britanike..

1.18.2 Tolerancat

- (1) Tolerancat e deklaruara në Kontratë duhet të maten pingul me vijat e specifikuar përveçse në rastet kur deklarohet ndryshe në Kontratë.
- (2) Nese pjesët fqinje të Punimeve janë subjekt i tolerancave dimensionale të ndryshme atëherë duhet të aplikohet toleranca me kritike në të gjitha këto punime që janë të lidhura me njëra-tjetren për sa i përket dimensionit, linjes dhe nivelit.

1.19 Venia në punë e vendit të punës

1.19.1 Përdorimi i vendit të punës

- (1) Vendi i punës nuk duhet të përdoret nga Kontraktori për asnjë qëllim tjetër përveçse ekzekutimit të punimeve ose kryerja e punëve të tjera që kanë lidhje me Punimet dhe të jenë të miratuara nga Supervizori.
- (2) Betoni dhe impianti miksi i ngritur në vendin e punës nuk duhet të përdoren për të siguruar beton për punime jashtë vendit të punës.
- (3) Bitumi dhe impianti miksi i ngritur në vendin e punës nuk duhet të përdoren për të siguruar materiale bitumi për punime jashtë vendit të punës.
- (4) Impianti shkëmb-thyres nuk duhet të ngrihet në vendin e punës përveçse në rastet kur përcaktohet në Kontratë.
- (5) Lokalizimi dhe madhësia e rezervave të materialeve, duke përfshirë dhe materialin e germuar, në vendin e punës duhet të jetë ashtu siç është rënë dakort nga Supervizori. Rezervat do të mbahen në kushte të qëndrueshme.
- (6) Hyrja dhe dalje nga vendi i punës duhet të merret vetëm në vendet e përcaktuara në Kontratë ose aty ku është rënë dakort nga Supervizori.

1.19.2 Paraqitja e të dhënave të hollësishme

- (1) Të dhënat e hollësishme si më poshtë duhet t'i dorëzohen Supervizorit për miratim jo më vonë se 14 ditë pas fillimit të punimeve:
 - a) vizatimet që tregojnë planin brenda në vendin e punës, akomodimin e Supervizorit dhe Kontraktorit, tabelat e mbishkruara të projektit, rruget e aksesit dhe objektet mëdha të kerkuara me heret në Kontratë.
 - b) vizatimet që tregojnë planin dhe detajet e ndërtimit të akomodimit të Supervizorit, dhe
 - c) vizatimet që tregojnë detajet që do të përfshihen në tabelat e mbishkruara të projektit..
- (2) Vizatimet që tregojnë lokalizimin e magazinave, zonat e magazinave, grumbullit-moster i materialeve bituminoze dhe të betonit dhe impianti i miksimit, impianti shkëmb-thyres dhe objekte të tjera që nuk janë kerkuar me heret në kontratë duhet t'i dorëzohet Supervizorit

per aprovim jo me vone se 28 dite perpara sesa objekte te tilla jane ndertuar ne vendin e punes.

1.19.3 Inspektimi ne vendin e punes

Nje inspektim ne vendin e punes per te vendosur kufijte e sakte te vendit te punes dhe nivelet brenda ne vendin e punes do te kryhen nga Supervizori pas spastrimit te vendit te punes, dhe perpara sesa punime te tjera te fillojne ne cdo zone qe eshte per t'u inspektuar. Kontraktori duhet te kryeje inspektimin se bashku me Supervizorin dhe te bien dakort per rezultatet sa me shpejt te jete e mundur pas mbarimit te spastrimit te vendit te punes, para se te fillojne punime te tjera ne zonen e inspektuar.

1.19.4 Rrethimet dhe shenjat ne vendin e punes

- (1) Rrethimet, gardhet, kalimet dhe shenjat ne vendin e punes duhet te mbahen ne kushte te pastra, te qendrueshme dhe te sigurta.
- (2) Tabelat e mbishkruara te projektit te percaktuara ne Kontrate duhet te montohen jo me shume se 4 jave, ose nje periudhe tjetere e miratuar nga Supervizori, pas dates se fillimit te Punimeve. Shenja te tjera reklamuese nuk duhet te ngrihen ne vendin e punes, vetem nese lejohet nga Supervizori.
- (3) Leja nga Supervizori duhet te jete marre perpara se rrethimet, gardhet, kalimet ose shenjat te jene hequr. Rrethimet, gardhet, kalimet dhe shenjat te cilat jane per t'u lene ne pozicion pas mbarimit te punimeve duhet te riparohen dhe te ri-lyhen sic eshte instruktuar nga Supervizori.

1.19.5 Akomodimi i Supervizorit ne vendin e punes

- (1) Akomodimi per t'u siguruar ne vendin e punes per Supervizorin duhet te jete gati per t'u zene, duke perfshire edhe lidhjet e te gjitha sherbimeve, jo me vone se 8 jave pas dates se miratimit nga Supervizori per vendin e propozuar, planin dhe detajet e ndertimit.
- (2) Akomodimi duhet te mbahet ne kushte te pastra, te qendrueshme dhe te sigurta dhe duhet te pastrohet te pakten nje here ne dite. Sherbimet nga nje sherbetor me kohe te plote duhet te sigurohen per Supervizorin.
- (3) Pajisjet e siguruar per perdorim nga ana e Supervizorit duhet te mbahen ne kushte te pastra qe te jene te dobishme dhe gjithate ato te konsumueshmet te plotesohen kur te kerkohet. Pajisjet e matjeve dhe testeve duhet te kalibrohen para se te perdoren dhe ne inetrvale te rregullta te miratuara nga Supervizori. Pajisjet e inspektimit duhet te mirembahen nga agjenti i sherbimit dhe duhet te kontrollohen rregullisht. Zevendesime ekuivalente duhet te sigurohen per pajisjet qe jane jashte sherbimit.
- (4) Leja nga Supervizori duhet te merret perpara sesa akomodimi ose pajisjet te jene hequr. Akomodim portabel do te levizet ne kohen e instruktuar nga Supervizori. Akomodimi ose pajisjet qe jane per t'u lene ne pozicion ose te behen prone e punedhensit pas perfundimit te punimeve duhet te riparohen dhe t'u behen sherbime sic instruktohet nga Supervizori.
- (5) Shenjat duhet te perputhen me Udhezuesin e Vizibilitetit te EU, Reg.CE 1159/2000

1.19.6 Akomodimi i kontraktorit ne vendin e punes

Zyrat e Kontraktorit, depot, magazinat, dhomat, dhe akomodime te tjera ne vendin e punes duhet te mbahen ne gjendje te pastere te qendrueshme dhe te sigurt. Akomodimi ku jetohet nuk duhet te sigurohet brenda ne vendin e punes percese ne rastet kur percaktohet ne kontrate ose miratohet nga Supervizori

1.19.7 Sherbimet ne vendin e punes dhe aksesit

- (1) Uje i perkohshem, drita, telefon, tuba kanalizimi dhe kullimi duhet te sigurohen per akomodimin e Supervizorit dhe per perdorimin e Kontraktorit gjate kryerjes se punimeve. Kontraktori duhet te beje te gjitha rregullimet dhe te marre aprovimet e nevojshme nga autoritetet perkatese per sherbimet.
- (2) Rruget e aksesit dhe zonat e parkimit duhet te sigurohen Brenda ne vendin e punes sic kerkohet dhe duhet te mbahen ne kushte te pastra, te kalueshme dhe te qendrueshme

1.19.8 Transporti per supervizorin

- (1) Transporti per Supervizorin duhet te sigurohet nga data e fillimit te punimeve pervecse ne rastet kur lejohet ose instruktohet ndryshe nga Supervizori.
- (2) Transporti duhet te jete per perdorimin ekskluziv te Supervizorit dhe personat e autorizuar prej tij dhe duhet te jete i disponueshem gjate gjithë kohes, gjate oreve normale te punes, dhe ne raste te tjera kur Kontraktori po punon ose kur instruktohet nga Supervizori. Transporti nuk duhet te perdoret nga Kontraktori ose nga persona te tjere.
- (3) Transporti duhet te mbahet ne kushte te pastra dhe te sherbyeshme ne nje menyre te rregullt. Karburanti, vaji dhe te tjera te konsumueshme, taksat, licensat, sigurimet, pagesat per bisedat telefonike , tarifet e ankorimit dhe parkimit duhet te sigurohen nga Kontraktori. Transporti nepermjete tokes duhet te jete i mbuluar me sigurim te plote qe perfshin edhe pergjegjesine e pasagjereve dhe qe lejon keshtu qe makina te drejtohet nga cdo shofer.
- (4) Te dhenat per udhetime duhet te mbahen ne ditare udhetime te siguruara nga Supervizori. Raportet duhet te perfshijne detaje te kohes dhe qellimit te udhetimeve me leximet perkatese te odometrit dhe te distances se pershkruar. Personi qe perdor transportin ose autorizon udhetime duhet te nenshkruaje poshte shenimeve hyrese te ditarit te udhetimeve. Ditaret e udhetimeve duhet te prezantohen per inspektim kur te kerkohet nga Supervizori dhe te gjithë ditaret qe jane te plotesuar duhet t'i dorezohen Supervizorit.
- (5) Transporti duhet te sigurohet deri ne fund te periudhes se mirmebajtjes ose ne nje date me te hershme te dhene nga Supervizori.

1.19.9 Pastrimi i vendit te punes

Punime te perkohshme te cilat nuk jane per te mbetur ne vendin e punes, duhet te hiqen nga vendi i punes pas perfundimit te punimeve ose ne raste te tjera te instrukuara nga Supervizori. Vendi i punes duhet te pastrohet dhe te kthehet ne gjendjen e meparshme sic ishte para se te fillonin punimet, ne menyre te tille do te veprohet pervec rasteve kur percaktohet ndryshe ne kontrate.

1.20 Mbledhjet

Agjenti i Kontraktorit duhet te marre pjese ne mbledhje dhe duhet te organizoje qe perfaqesuesit dhe nen-kontraktoret, departamentet e qeverise, kompanite e transportit ndermarjet e sherbimeve dhe Kontraktore te tjere te marrin pjese ne keto mbledhje kur kerkohet nga Supervizori. Kontraktori duhet te informoje Supervizorin 48 ore perpara, ose nje periudhe tjeter kohore rene dakort nga Supervizori, perpara sesa te fillojne mbledhjet me departamentet qeveritare, kompanite e transportit, ndermarjet e sherbimeve dhe Kontraktore te tjeredhe duhet t'i jape Supervizorit mundesine per te marre pjese ne keto mbledhje.

1.21 Fotografi

Fotografi me ngjyre, duke perfshire edhe fotot nen uje, qe tregojne progresin e punes dhe cilesine e materialeve dhe mjeshterine e punimeve duhet te behen ne kohen dhe vendet e instrukuara nga Supervizori. Mbi foto duhet te jene te shenuara koha, data dhe vendi

2. PASTRIMI

2.1 Kërkesa te pergjithshme

Punet dhe materialet e specifikuara ne Piken 202 duhet te perputhen me seksionet e percaktuara, pervecse ne rastet kur percaktohet ndryshe ne kete seksion.

2.2 Punimet e dheut

Punimet e dheut duhet te perputhen me Seksionin 3.

2.3 Prishjet

- (1) Zonat perreth prishjeve duhet te mbrohen nga demtimi qe shkakton ajo; pluhuri qe ngrihet nga punimet e prishjes duhet te kontrollohet nga rrjeta dhe me sperkatje uji.
- (2) Strukturat qe duhet te prishen duhet te survejohen nga Kontraktori, dhe rezultati i duhet dhene per informacion Supervizorit, perpara se te filloje prishja.
- (3) Te dhena per metodat e propozuara per kryerjen e prishjeve duhet t'i dorezohen Supervizorit per informacion te pakten 14 dite perpara se te filloje prishja.

2.4 Tuba dhe kablo

Kontraktori duhet te beje te gjitha rregullimet dhe te marre miratimet e nevojshme nga autoritetet perkatese per shkeputjen e sherbimeve Brenda dhe jashte zones se punes. Pikat fundore te sherbimeve te keputura duhet te behen mire dhe te izolohen dhe duhet te markohen me shenja te dukshme ose me metoda te tjera te miratuara nga Supervizori.

2.5 Pemet

Rrenjet e pemeve dhe shkurreve te cilat jane prere duhet te pastrohen. Deget nuk duhet te levizen nga pemet te cilat do te mbahen, pervecse kur lejohet nga Supervizori, e nese lejohet, deget duhet te hiqen ne perputhje me BS 3998 dhe siperfaqet e prera duhet te trajtohen me nje izolues demtimi sic miratohet nga Supervizori.

2.6 Rivendosje e gjendjes se meparshme

- (1) Pervecse ne rastet kur lejohet ndryshe nga Supervizori, zonat e ndikuara nga pastrimi i vendit te punes duhet te rikthehen ne gjendjen e meparshme sic percaktohet ne Piken 206(2)deri(5).
- (2) Materiali i imet mbushes duhet te depozitohet ne boshllqe ose gropa qe jane lene ne terren.
- (3) Vrimat te cilat jane lene ne struktura dhe ne dysheme duhet te rregullohen duke perdorur material te njejte me ate te zones fqinje.
- (4) Fundet e gardheve, mureve, strukturave, sherbimeve dhe sendeve te tjera duhet te behen mire dhe ne nje menyre te tille qe pjeset e ndikuara nuk do te prishin ose shkaterrojne, dhe do te mbeten te qendrueshme.
- (5) Vendet e tendosura duhet te fiksohen me anen e gardheve ose rrethimeve.

2.7 Materialet dhe pajisje per riperdorim dhe magazinim

- (1) Sendet qe jane per t'u riperdorur ose per t'u magazinuar do te jene shperbere dhe do te hiqen nga nje metode e pershtatshme per te menjanuar demtimin nese kjo eshte e pashmangshme. Sendet do te pastrohen perpara riperdorimit ose magazinimit.
- (2) Sendet te cilat jane per t'u riperdorur ne punimet duhet te mbahen ne magazina te siguruara nga Kontraktori.
- (3) Sendet te cilat jane per t'u cuar ne magazinën e Punedhënesit duhet te shperndahen nga Kontraktori.
- (4) Materialet ose pajisjet te cilat jane per t'u riperdorur ose magazinuar dhe te cilat jane demtuar si pasoje e neglizhences se Kontraktorit, atehere duhet te riparohen nga Kontraktori me ane te nje metode te miratuar nga Supervizori. Materialet ose pajisjet te cilat kane humbur ose sipas Supervizorit nuk jane ne gjendje te riparohen me do te zevendesohen nga Kontraktori. Përveç sendeve qe jane per t'u riperdorur ose magazinuar, sende te demtuara, peme, shkurre, bimesi, gure , mbeturina, plehra dhe sende te tjera qe dalin nga pastrimi i punes duhet te depozitohen nga Kontraktori dhe do te behen prone e Kontraktorit kur te largohen nga vendi i punes.
- (5) Depozitimi i materialeve duhet te behet vetem ne vende te licensuara. Materiale si asfalti mund te kene nevoje per nje depozitim special ose te riciklohet.

3. PUNIMET E DHEUT

3.1 Pastrimi i zones

Ne te gjithë zonen ku jane bere punime, do te kryhet heqja e pemeve, shkurreve, trunjeve, rrenjeve, dhe do te behet mbledhja e tyre ne pirgje.

Si rregull, ky veprim do te kryhet ne nje brez prej 6 metrash nga zona ku do te kryhen punimet. Pirgjet do te digjen ; produktet qe mbeten nga keto veprime do te hiqen nga zona e punes.

Do te perdoren pajisjet qe jane konsideruar si me te pershtatshmet per keto veprime. Kontraktuesi duhet te evitoje heqjen e piketave te cilat jane vendosur jashte. Nese do te kete ndonje prishje te piketave atehere duhet te behet restaurimi i tyre nga ana e kontraktuesit.

Pastrimi do te konsistoje ne pastrimin e terrenit nga pemet, shkurret, trunjet dhe te tjera bimesi si dhe nga te gjitha mbeturinat dhe cdo lloj materiali te pakendshem dhe pengues.

Perfshihet gjithashtu dhe shkulja dhe pastrimi i te gjitha rrenjeve, pervec rasteve kur jane lene per te parandaluar erozionin ose gerryerjen, dhe aty ku kerkohet, te behet mbushja me material te pershtatshem i te gjitha gropave te vogla te hapura si pasoje e shkuljes se rrenjeve dhe pastrimit. Materiali qe mbush pjesen e poshtme te strukturave duhet te jete kompakt sipas ngjeshjes Proktor , te specifikuar per strukturat themelore sic pershkruhet ne Piken 304

Gure te izoluar dhe pengesa me te medha se 0.25 (cereku i nje te plote) meter kubik ne madhesi do te depozitohen ne zonat ne dispozicion per materiale te germuara qe jane te papershtatshme dhe te teperta.

3.2 Pergatitja e bazes per ndertimin e argjinatures

Baza e rruges, oborri, dhe cdo argjinature tjeter kompakte, si rregull eshte hequr ne nje thellesi prej 10 cm. Veprimi do te perfshije heqjen e shtreses se punueshme, barit, mbetjeve barishtore dhe tokes se shtrengueshme.

Rrjeta e telavemund te perjashtohet, sipas instruksioneve te Supervizorit, kur konsiderohet e panevojshme, ndikuar nga karakteristikat e tokes.

Ne kete rast, volumi i tokes i hequr poshte thellesise prej 10 cm do te konsiderohet si germim i pergjithshem ne toka te zakonshme.

Te gjitha produktet e nxjerra do te vendosen jashte zones se punes dhe nuk do te riperdoren per ndertime argjinaturash.

3.3 Germimi

Germimi, heqja, transporti, dhe pajisje te tjera qe ndeshen me cdo lloj materiali, do te sigurohen, dhe germimi per punimet do te kryhet ne te tilla gjeresi, gjatesi, thellesi, linja dhe shkalle qe jane specifikuar ne projektin final. Materialet qe jane per t'u germuar ndahen ne dy klasa si me poshte:

- (1) TOKE E ZAKONSHME, qe perfshin te gjitha materialet pervec tokes se forte, duke perfshire por jo duke u kufizuar ne toke, zhavorr, shkembinj te bute ose te shperbere qe mund te hiqen ne menyre efikase nga makinerite e germimit, gjithashtu te gjithe guret ose copat e shkeputura te shkembinjve solide qe nuk kalojne 0,5 meter kub ne madhesi.
- (2) TOKE E FORTE, qe perfshin te gjithe materialin qe ndodhet ne shtresa xeherore ose masa te cilat mund te prishen vetem me ane te produktivitetit standart per nxjerrjen e mevonshme me ane te menyrave te pershtatshme ose veglave thyerese qe operojne mekanikisht ose me ane te trapanave apo eksplozivit.

I gjithe materiali i germuar, kur te jete e pershtatshme, do te riperdoret gjate ndertimit te punimeve. Te gjitha materialet e papershtatshme dhe materialet qe jane me te medha se permbushja e kerkesave, sic specifikohet ose tregohet ne Projektin Final, do te depozitohen ne zonat e miratuara.

3.4 Germimi i kanalit per shtrirjen e tubit

Germimi duhet te behet duke ndjekur ekzaktesisht shtrirjen dhe seksionet e treguara ne Vizatimet ose sipas udhezimeve te Supervizorit. Kontraktori do te jete pergjegjes per te gjitha demtimet eventuale te shkaktuara ndaj ndertesave ose infrastrukturave si pasoje e nje lidhjeje te pamjaftueshme te seksionit te pershkruar te kanalit

Skema e dhene ne vizatimet jep vetem nje paraqitje te pergjithshme dhe Supervizori mund ta ndryshoje ate duke u bazuar ne karakterisitkat gjeoteknike te vendit, ose nderhyrjes eventuale dhe Kontraktori nuk mund te kerkoje kompensim per shkak te ketyre ndryshimeve, duke tejkualuar cmimin e ofertes ne liste per kete artikull. Germimi duhet te behet duke ndjekur llojet e seksionit te dhena ne skeme dhe nga Kontraktori, nese eshte e nevojshme, duhet te mbeshetet me ane te nje perforcimi te mjaftueshem dhe traversave, pa ndonje pagese ekstra, dhe duhet te jete pergjegjes per cdo demtim te shkaktuar ne rast te ndonje rreshqitjeje.

Fundi i kanalit duhet te jete i sheshuar dhe i niveluar, me gradientin e kerkuar per shtrimin e tubave ne perputhje me Vizatimet. Cmimi i ofertes ne preventiv per germim kanali perfshin te gjitha veprimet e germimit, dhe perfshin te gjitha kostot per ndricimet e nates dhe cdo sinjal tjeter, qe jane te nevojshem per te garantuar sigurine e njerezve dhe trafikun lokal gjate gjithe periudhes qe kryhen punimet, si gjate dites ashtu edhe gjate nates. Matjet per pagesen e germimit te kanalit do te behen ne perputhje me karakteristikat e seksionit (gjeresia e kanalit, pjerresia anesore) te treguara ne Vizatimet, gje qe ndoshta nuk garanton stabilitetin e kanalit dhe Kontraktori nuk mund te kerkoje ndonje kompensim per germim ekstra apo per traversat e perdorura dhe perforcimet e bera ne kanal.

Ne çfaredo rasti që Kontraktori do të gjeje gjatë germimit të kanalit; tuba uji, linja telefonike, kablllo elektrike, ose tuba të shërbimeve të tjera publike, ai duhet të informojë menjëherë Supervizorin dhe Agjensinë përkatëse, dhe duhet të sigurojë zgjidhjen më të mirë për të suportuar në një mënyrë të përshtatshme dhe me materialin e duhur, duke bërë kontrolle të vazhdueshme për të evituar rrisqet e demtimit, duke ndjekur instruksionet e dhëna nga Supervizori dhe agjensia përkatëse të shërbimeve publike.

3.5 Materiali i germuar

Pa ndonjë cmim shtesë, materiali i germuar, i cili konsiderohet nga Supervizori i përshtatshëm për mbushje, duhet të ndahet në pirgje/grumbuj të ndryshëm duke u bazuar në karakteristikat e secilit pirg. Operacioni i germimit duhet të kryhet eventualisht në fazë të ndryshme në mënyrë që materialet e përshtatshme mund të shpëtohen përpara se të thellohet kanali.

Zakonisht pirgjet e dheut behen përgjatë kanaleve, në mënyrë që të shmangët ndonjë ndërhyrje në aktivitetet e punës ose në trafik. Kontraktori duhet të adoptojë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar çdo depërtim të ujërave sipërfaqësore brenda në kanal ose ndonjë rreshqitje e mundshme.

Materiali që nuk mund të ripërdoret ose që është i tepërt duhet të transportohet direkt në landfillin (vendin e gropës) e autorizuar ose aty ku do të drejtohet nga Supervizori. Transporti dhe kostot për materialin e tepërt konsiderohen të përfshira në ofertën e çmimeve në preventivin për germimin e kanalit.

3.6 Mbushja

Mbushja e kanaleve duhet të bëhet si vijon:

- (1) Tubat dhe objektet e parapergatituranuk duhet të kalojnë nën blloqet mbështetëse ose notimi;
- (2) Dheu dhe materiali mbushës duhet të ngjeshet për të zvogëluar faktorin e ngarkesës së përqendruar në tubacion.

Mbushja e tubit bëhet në dy faza: shtrati poshtë tubit dhe ajo sipër tij dhe mbushja e kanalit, për të cilat do të përdoren materialet si më poshtë:

- a) rera e një granulometrie të mirë, pa materiale të padëshirueshme, pa gunga dhe pa zhavorr të mbajtur në siten me brimea 30 mm, për shtratin dhe mbushjen deri në lartësinë e përkthuar mbi koken e tubit dhe kompaktësimi me dorë,
- b) materiali nga germimi, nëse është e përshtatshme, ose nga gropat e huazuara, materiali i përshtatshëm duhet të jetë i një grade të mirë, jo plastik, dhe kompakt në shtresë që nuk i kalojnë 150 mm, në rastin e tubave poshtë pllakave të betonit, ose sipërfaqeve të tjera të ngurta të shtruara, duhet të përdoret zhavorr i një grade të mirë, pa materiale të padëshirueshme, që e kalon siten 75 mm, që shtrihet në shtresë 150 mm të trasha.

Kompaktësimi duhet të kryhet me anën e pajisjeve sa më të përshtatshme, në të dyja anët e tubit në të njëjtën kohë, duke shmangur gjenerimin e kryqezimeve pluskuese dhe pa induktuar ndonjë levizje të tubave.

Po aq shpejt sa lerimi i tokës duhet të bëhet edhe operacioni i mbushjes, duke kompaktuar materialin në shtresë të ndryshme, duke përdorur pajisjet më të përshtatshme për token prezente në vendin e punës, pa shkaktuar demtime në tub.

3.7 Germimi ne presence te ujit

Ky term tregon germimet e kryera nen nivelin e ujerave nentokesore. Te gjitha masat e nevojshme dhe pajisjet per tharjen e ujit duhet te perdoren qe vendosja e tubave apo hedhja e themeleve te jete kryer.

3.7.1 Pershkrimi

Ky seksion specifikon performancen e tharjes nga uji qe kerkohet per te ulur dhe kontrolluar nivelet e ujit nentokesor si dhe presionin hidrostatik per te lejuar germimin, mbushjen dhe ndertimin qe do te kryhet ne te thate. Kontrolli i ujerave siperfaqesore duhet te konsiderohet si pjese e punes nen kete specifikim.

3.7.2 Permbledhje

Puna qe do te komplotohet nga Kontraktori perfshin sa vijon, por nuk eshte se kufizohet domosdoshmerisht si me poshte:

- (1) Zbatimi i Planit te Kontrollit te Erozionit dhe Sedimentimit.
- (2) Germime te tharjes, duke perfshire kullimin dhe precipitimin.

3.7.3 Kerkesa

- (1) Kontraktori do te jete pergjegjes per te siguruar te gjitha materialet, pajisjet, punen dhe sherbimet e nevojshme per kujdesin e ujit dhe kontrollin e erozionit. Punimet e germimeve nuk duhet te fillojne perpara se te vendoset Plani i kontrollit te erozionit dhe sedimentimit.
- (2) Sistemi i tharjes duhet te jete i nje madhesie dhe kapaciteti te mjaftueshem per te ulur dhe mirembjatur nivelin e ujerave nentokesore ne nje kuote te pakten 300 mm (1 kembe) nen themelin me te ulet ose fundin e kanalit te tubit dhe ne menyre qe te lejoje materialin qe te germohet ne nje menyre te arsyeshme dhe ne te thate. Materialet qe do te hiqen do te jene mjaftueshmerisht te thate per te lejuar germimin qe te pershkallezohet poshte dhe qe te stabilizojte pjerresite e germimit aty ku nuk kerkohet perforcuese. Sistemi i tharjes te funksinoje derisa te perfundoje puna e mbushjes.
- (3) Kontraktori do te ule koken hidrostatike poshte cdo germimi ne ate mase qe niveli i ujit ne zonen e ndertimit eshte ne nje minimum prej 300 mm (1 kembe) poshte siperfaqes ekzistuese te germimit.
- (4) Kontraktori do te parandaloje humbjen e fines, kullimit, vlimit (avullimit), kushteve te shpejta ose zbutjen e shtresave baze.
- (5) Kontraktori do te mbaje stabilitetin e aneve dhe fundit te germimit.
- (6) Veprimet e ndertimit duhet te kryhen ne te thate.
- (7) Kontrolli i siperfaqes dhe nen-siperfaqes se ujit eshte pjese e kerkesave te tharjes. Kontraktori duhet te mbaje nje kontroll adekuat ne menyre qe:
 - Stabiliteti i shpateve te germuara dhe te ndertuara nuk ndikohen nga toka e ngopur, duke perfshire dhe futjen e ujit ne nen-baze dhe nen-grade aty ku materialet baze nuk jane me tharje te lire ose jane subjekti i veprimit te ngrirje-shkrirjes.
 - Erozioni eshte i kontrolluar.
 - Permytja e germimeve ose demtimi i strukturave nuk ndodh.
 - Ujerat e siperfaqes derdhen larg nga germimet.
 - Germimet jane te mbrojtura lagia nga ujerat siperfaqesore, ose te sigurohet qe germimet jane te thata perpara sesa te ndermerret ndonje punim shtese.

- (8) Kerkesat e lejuara:

Kontraktori duhet te jete ne perputhje dhe te marre lejet e kerkuara nga Shteti dhe Rrethi ku realizohet puna.

3.7.4 Instalimi

- (1) Kontraktori duhet të instalojë një sistem tharje për të ulur dhe kontrolluar nivelin e ujerave nentokesore në mënyrë që të lejohet germimi, ndertimin e struktureve, dhe vendosjen e materialeve të mbushjes që të kryhen në kushte të thata. Sistemi tharjes të bëhet i përshtatshëm që të para-thahen shtresat ujembajtëse sipër dhe poshtë pjesës së poshtme të struktureve të themeleve, shërbimeve dhe germimeve të tjera.
- (2) Për më tepër, Kontraktori duhet të ulë koken e presionit hidrostatik në shtresën ujembajtëse poshtë struktureve të themeleve, linjat e shërbimeve dhe germimeve të tjera, në atë masë që nivelet e ujit në zonën në ndërtim janë në një minimum prej 300 mm (1 këmbë) poshtë sipërfaqes ekzistuese të germimeve gjatë gjithë kohës.

3.7.5 Operimi

Perpara çdo germimi poshtë ujerave nentokesore, Kontraktori duhet të verë sistemin në funksionim për të ulur nivelin e ujerave nentokesore ashtu siç kërkohej dhe për të funksionuar në mënyrë të vazhdueshme 24 orë në ditë, për 7 ditë e javës, derisa shërbimet dhe strukturat janë ndërtuar në mënyrë të kënaqshme, gjë që nënkupton se vendosja e materialeve të mbushjes dhe tharja nuk janë më të nevojshme.

Kontraktori duhet të vendosë një peshe adekuate të materialit mbushës për të parandaluar notiminpara se të ndërpritet sistemi i operimit.

3.7.6 Shkarkimi i Ujit

Kur shkarkohet uji, Kontraktori:

- Nuk do të rrezikojë pjesë të punës në ndërtim e sipër ose të përfunduara.
- Nuk do të shkarkojë ndonjë shqetësim qeverisë ose të tjerëve që punojnë afër vendit të punës.
- Do të jetë në përputhje me dispozitat e lejeve të nevojshme për shkarkimin e ujit.
- Do të kontrollojë prurjet: Kontraktori do të jetë përgjegjës për kontrollin e prurjeve në të gjitha zonat e punës duke përfshirë por jo duke u kufizuar vetëm në: germime, rruget e hyrjes, zonat e parkimit, shtrimin, dhe zonat e skeles. Kontraktori duhet të sigurojë, vendosë në funksionim dhe në mirëmbajtje të gjitha kanalet, basenet, gropat, nenkalimet e ujerave, vendet e fraksionimit, dhe pajisjet e pompimit për të devijuar, mbledhur dhe levizur të gjithë ujin nga zonat e punës. I gjithë uji duhet të hiqet nga zonat momentale të punës dhe duhet të shkarkohet në përputhje me lejet e zbatueshme.

3.7.7 Heqja e ujit gjatë germimeve

- (1) Kontraktori do të jetë përgjegjës për sigurimin e të gjitha pajisjeve të nevojshme për të devijuar, mbledhur, kontrolluar dhe për të hequr ujin nga të gjitha zonat ku punohet, ndërtohet dhe germohet.
- (2) Kullimet duhet të kenë kapacitetin e mjaftueshëm për të shmangur përmytjen në zonat e punës.
- (3) Karakteristikat e kullimeve duhet të jenë të organizuara dhe të alternuara në mënyrë të tillë siç nevojitet për të evituar degradimin e sipërfaqes (sipërfaqeve) përfundimtare të germimit.
- (4) Kontraktori duhet të perdorë të gjitha masat e nevojshme të kontrollit të sedimentimit dhe erozionit siç përshkruhet për të shmangur ndërtimin që lidhet me cilesinë natyrale të ujit.
- (5) Pajisjet e tharjes së ujit duhet të sigurohen për të hequr dhe shkarkuar nga çdo sipërfaqe dhe ujera nentokesore që hyjnë në germimet, hendeqet ose kanalet apo pjesë të tjera të punës gjatë ndërtimit. Çdo germim duhet të mbahet i thatë gjatë fazës së përgatitjes së tresesë dhe në vazhdim derisa struktura që do ndërtohetose tubi që do shtrohet aty, është kompletuar në masën që nuk do të rezultojë të ketë demtime nga presioni hidrostatik, pluskimi ose shkaqe të tjera.

3.7.8 Pajisjet e gatishmerise

Kontraktori duhet te siguroje komplet pajisjet e gatishmerise, te instaluara dhe ato te gatshmet per nderhyrje te menjehershme, sic mund te jete e nevojshme per te mbajtur ne menyre adekuate tharjen e ujit ne menyre te vazhdueshme, dhe ne rast se te gjitha ose ndonje pjese e sistemit mund te behet e papershtatshme ose te deshtoje.

3.7.9 Veprim korrigjues

Nese kerkesat e tharjes se ujit nuk jane te plotesuara per shkak te paaftesise ose deshtimit te sistemit te tharjes se ujit (renie e shtreses se themelit, ose mungese stabiliteti e shpateve, apo demtim i themeleve apo strukturave), Kontraktori duhet te beje punen e nevojshme per rivendosjen e tokes se themeleve dhe strukturen e demtuar qe rezulton nga paaftesia ose deshtimi i Kontraktorit, pa kosto shtese per Agjensine e Kontraktimit.

3.7.10 Demtimet

Kontraktori duhet te riparoje menjehere demtimet ndaj pajisjeve ngjitur te shkaktuara nga operacionet e tharjes se ujit.

3.7.11 Heqje

Kontraktori duhet te siguroje perputhjen me te gjitha kushtet e lejeve rregulluese dhe te siguroje nje informacion te tille ndaj Inxhinierit te Zbatimit. Te marre miratim me shkrim nga Inxhinieri Zbatimit perpara se te nderpritet funksionimi i sistemit te tharjes.

3.8 Palankolat

3.8.1 Percaktimi

Nje palankoleshte krijuar nga seksione metalike, pergjithesisht te karakterizuar nga nje forme U e hapur. Buzet anesore jane ne forme te tille qe te udhezojne zhvendosjen e seksionit ngjitur, te rregulluar ne pozicionin e kundert simetrik.

Pergjithesisht shtyllat metalike perdoren per te krijuar nje suport te perkohshem per germime te ceketa. Ne te tilla raste shtyllat rikuperohen duke i nxjerre me ane te nje vibratori. Perdoren me rralle per te ndertuar suportte afatgjata ose struktura mbrojtese. Ne raste te tilla, shtylla te perforuara prej betoni mund te perdoren, duke perfshire beton te parafabrikuar i krijuar duke perdorur tekniken e telave pasues.

3.8.2 Rregulloret e references

- (1) ASTM DII43-81 " Metoda e Testit Standart per shtyllat nen ngarkesa shtypese dhe statike".
- (2) DIN 4150.

3.8.3 Permbledhjet

Kontraktori duhet t'ja komunikojte Supervizorit menyren e zbatimit qe ka per qellim te perdore. Duhet te siguroje konformitet me rregulloren DIN 4150 per sa i perket pikes se shkalles se vibrimevedhe masat qe do perdoren nese shkalla e dridhjeve eshte tejkualuar.

Supervizori mund t'i kerkoje Kontraktorit te kryeje teste kontrolli per vibrimet, ku Kontraktori duhet te paguaje cdo detyrim e shpenzim lidhur me kete.

3.8.4 Ndhimat gjeometrike

Lejohen tolerancat si me poshte:

- Pozicioni planimetrik i aksit kryesor te shtylles: ± 3 cm
- vertikalteteti: ± 2 %

- lartësia e kokës: ± 5 cm
- thellesia: ± 25 cm

Nese hasen pengesa ne shtylla, Kontraktori duhet te kufizojë shtyllen ne nivele me te larta, duke prere pjesen e sipërme te shtyllës qe tejkalon lartësine e specifikuar te kokës, duke ndjekur marreveshjen me Supervizorin dhe pas nje testi percaktimi harmonie.

3.8.5 Pergatitja e siperfaqes se punes

Siperfaqja e punes duhet te jete e pershtatshme per dimensionin e pajisjeve qe nevojiten; lartësia e tyre duhet te lejoje te arrihen lartësite e skicuara te kokave te shtyllës.

3.8.6 Materialet

Shtyllat metalike duhet te kene formen, seksionin, gjerësinë dhe gjatësinë sic raportohet ne dokumentin e skicuar, ose ne rastin e strukturave te perkohshme, duhet te jene ne gjendje te rezistojne ne maksimum presionit gjate fazes se ndertimit, ne funksionim normal, dhe perfundimisht gjate nxjerrjes ose fazes se largimit
Shtylla prej celiku duhet te kete karakteristikat si me poshte (nese nuk raportohet ndryshe ne skicim):

- Forca e thyerjes (breaking stress) $f_t = 550 \text{ N/mm}^2$;
- Limiti elastik $f_y = 390 \text{ N/mm}^2$;

Siperfaqja e shtyllës duhet te jete e mbrojtur ne menyre te pershtatshme duke perdorur nje shtrese te holle bitumi ose material tjetër mbrojtës. Skajet zhytese duhet te jene persosmerisht ne linje dhe te paster.

3.8.7 Marreveshjet e zbatimit

Ndertimi i shtyllave te perkohshme ose te perhershme kerkon adoptimin e masave per te siguruar konformitetin me specifikimet e skicimit, ne menyre te vecante per sa I perket vertikaltetit, bashkeplanit, bashkimit te elementeve dhe rezistencen ndaj ngarkesave anesore.

Pajisjet levizese dhe nxjerrëse duhet te perputhen me karakteristikat e percaktuara nga Kontraktori per te siguruar depertimin e kerkuar nga stratigrafia lokale dhe mundesine per te nxjerre elementet e perkohshem.

Depertimi do te kryhet nepermjet shpimit duke perdorur nje transmission shtylle ose nepermjet vibrimit duke perdorur nje ekstrakt shtylle me vibrim.

Palankola zhytesedo te ece neper nje kulle me udhezime fikse dhe me linja kryesore fikse te karakterizuara nga specifikimet teknike(nese ekzistojne)

Nje vaporizues uji ose nje palankol zhyteseme naftë qe mund te perdoret duhet te jete ne gjendje te prodhoje energji te mjaftueshme per te depertuar token .Batipali ose cekici godites i perdorur duhet te kete nje koke zhytese te tille qe ta mbroje palankolen nga demtimet e padeshiruara.

Kontraktori duhet te siguroje informacionin e meposhtem per secilen pjese te pajisjeve:

- Prodhuesi i palankoles zhytese dhe lloji;
- Parimet e punes;
- Maksimumi i energjise goditese dhe mundesite e rregullimit te intensitetit;
- Numri i goditjeve ne minut dhe mundesite e rregullimit te frekuences;
- Tipologjia e kokës zhytese;
- Pasha e palankoles zhytese.

Vibratori/Njerresi i palankoles zhytese duhet te kete nje mase te kontrollueshme jashtqendersie dhe nje parim pune hidraulik ose elektrik.

Kontraktori duhet të zgjedhë karakteristikat e pajisjeve në varesi të qëllimeve të kërkuara, mundësisht duke ndjekur paraprakisht provat teknologjike. Këto karakteristika përfshijnë por nuk kufizohen në: momentin e jashtëqendërsisë numrin e vibrimeve në minute, forcën centrifugale fillestare, amplitudën dhe nxitimin fillestar.

Palankola do të jetë metalike dhe konform specifikimeve të projektuara. Palankola mundësisht do të instalohet duke përdorur një zhytes për germime me të dimensionet e pershtatshme.

Kontraktori duhet të ia përftojë katalogun e instalimit të palankoles supervisorit para fillimit të punimeve.

Pilota zhytëse duhet të zhytet në mënyrë perfekte dhe efiçente dhe duhet të vazhdojë deri sa të arrihet thellesia specifike e kërkuar. Nëse thellesia e penetrimit nuk ndryshon pas 50 goditjeve (penetrim me pak se 10 cm) atëherë është arritur thellesia e moproprimit dhe procedura e zhytjes duhet të ndalojë.

Pasi të jetë informuar supervisorin kontraktori mund të përdori injektim uji për të lehtësuar penetrimin. Ocurtë Supervisor hasbeen informed, the Contractor can use water injections to facilitate the penetration brenda niveleve të kokrrizave të imta. Metoda, presionet dhe shkarkimet e rrymave të ujit duhet të raportohen supervisorit.

Kur nuk mund të arrihet thellesia e projektuar ose haste ndonjë anomali (në të dy rastet e vibrimit dhe metodologjise zhytëse), Kontraktori duhet të informojë menjëherë Supervisorin.

Palankolat për struktura të perkohshme do të hihen nga terheqje të simuluar dhe vibrime.

Pasi të jetë përfunduar heqja kushtet e palankoles do të analizohen me qëllim që të raportohen shtremberimet, deformimet ose demet.

3.8.8 Kontrolli i materialit

Celiku i përdorur në konformitet me specifikimet e projektuara duhet të testohet. Për më tepër certifikata e çdo grupi shufrash të furnizuara nevojitet të verifikohet.

Pa këto dokumente struktura nuk mund të instalohet.

3.8.9 Kontrollët e instalimeve

Gjatë punës së palankoles zhytëse do të numerohet numri i goditjeve të nevojshme për të avancuar me 1m. Numri i goditjeve për çdo 10cm do të numerohet në metrat e fundit nëse kërkohet nga ana e Supervisorit.

Pasi të jetë përfunduar zhytja e palankoles Kontraktori duhet të kontrollojë pozicionin në altimetri dhe bashkimin afektiv të elementit. Për secilën faqe palankole të zhytur të futur nga vibratorit ose palankola zhytëse, për më tepër për të kontrolluar tolerancat, Kontraktori duhet të plotësojë një formular:

- Numrin progresiv të elementeve të palankolave të treguara sipas planit të projektit
- Të dhëna teknike për pajisjet
- Koha e kërkuar për instalimin
- Informacione lidhur me tratigrafine lokale
- Tabela goditjeve që nevojitet për të avancuar (atje ku është e aplikueshme)
- Shenime shtesë për ndonjë anomali ose pengesë.

Kontraktori duhet të komunikojë Supervisorit për ndonjë anomali ose pengesë lidhur me statigrafine e parashikuar, pafshesinë për të arritur thellesinë e specifikuar nga projekti ose ndonjë anomali tjetër në mënyrë për të arritur një marrëveshje për ndryshimet e nevojshme në projekt ose modifikime të tjera të pershtatshme.

Gjatë fazës së heqjes, një forme e ngjashme e përkohshme si më lart duhet të mbushet për të verifikuar integritetin e nxjerrjes.

3.9 Zonat e huazuara

Të gjitha materialet e kërkuara për:

- Ndertimi i rrugëve ose rrethimi i kantiereve;
- Mbushjet;
- Grumbullimi i grimcuar dhe rere për beton;
- Baza e rruges, nënbaza e trotuarit;

Mund të përftohen nga punimet e germimeve, kur është e pershtatshme, dhe nga zonat zyrtare të huazuara të treguara nga ana e Kontraktorit dhe të verifikuara dhe aprovuara nga ana e Supervizorit.

3.10 Vendosja e materialit të germuar

Të gjitha materialet e germuara të cilat nuk mund të riperdoren për ndertimin e argjinaturës ose mbushjes duhet të depozitohen në vende të aprovuara nga Supervizori.

Si rregull, vetëm nëse parashikohet ndryshe, depozitimi i mbeturinave duhet të jetë jashtë zonës së punës, dhe, në çdo rast, duhet të hidhen në një mënyrë të tillë që të mos shkaktohet ndonjë pengesë në rrjedhjen e ujit, dhe mundësisht të hidhen në depresionet e terrenit. Çmimi për heqjen e materialeve nga germimet është menduar të përfshihet në preventiv në zerin e punimeve të germimeve.

3.11 Kontrolli i punimeve të dheut

Pajisjet laboratorike për të kryer marrjen e mostrave dhe testimin e materialeve të tokës për punimet tokësore duhet të përftohen nga ana e Kontraktorit dhe duhet të përfshijnë marrjen e mostrave dhe testimin e tyre të pranueshme për supervizorin të cilat mund të jenë të nevojshme për trajtimin e mostrave dherave.

Pajisje të tilla duhet të përfshijnë pajisjet e nevojshme për të kryer testimet e nevojshme:

- Analiza e grimcave të dheut
- Përcaktimi i lageshtësisë së dheut
- Testimi i densitetit të zonës
- Testimi i ngjeshjes proktor

Pas rezultateve laboratorike puna e marrjes së mostrave dhe testimi i tyre i duhet paraqitur Supervizorit për miratimin nëse ato janë të pershtatshme për qëllimin e synuar.

Kostoja e sigurimit të objekteve dhe hapësirave të punës për trajtimin e mostrave përfaqësohet të materialeve tokësore duhet të përfshihet në çmimet e ofertës në zerin e punimeve që lidhen me punimet tokësore.

Pas testeve paraprake, numri dhe lloji i secilit kampion duhet të jetë sipas udhëzimeve të Supervizorit me qëllim që të sigurohet se punimet konstruktive janë duke dhënë rezultatet e kerkuara, duhet të kerkohet lloji dhe numri minimal i testeve.

(1) për mbushje të ngjeshura dhe rimbushje pashte strukturave:

- a) Ngjeshje me krah: një testim densiteti të terrenit dhe një testim Proktor për 50m³ të vendosur.
- b) Ngjeshje me cilindër: një testim për çdo 500m³ të vendosur.

(2) për secilen do të bëhet një provë papershkueshmërie në laborator

(3) Testime të densitetit të terrenit për argjinaturat dhe mbushjet.

Numri i testeve të mesiperme mund të rritet ose nëse kerkohen tipe të tjera testimesh sipas udhëzimeve të Supervizorit.

Pozicioni i testeve të terrenit do të vendoset nga ana e Supervizorit dhe përcaktohet nga ana e Kontraktorit në drejtim të stacioneve, në njërën anë të rruges ose strukturave qendrore me kuote mbi fund

4. BETONI

4.1 *Betoni i zakonshem – materialet perberes*

Betoni do te perbehet nga perzierja e cimentos , materialit te granular dhe uje,te vendosura dhe te ngjeshura sipas specifikimeve ne klauzolat e meposhtme.

4.1.1 Referenca

- EN 206-1: 2000 Betoni – Pjesa 1: Specifikimet , Performanca , Prodhimi dhe Pershtatja .
- BS 8500 Betoni – Standarti Britani Plotesues i BS EN 206-1.
- Pjesa 1: 2002 Medoda e specifikimeve dhe udhezuesi per Specifikuesin.Pjesa 2;2002 Specifikimet per materialet perberese dhe betonin EN 1990: 2002 Eurokodi – Bazat e projektimit te Strukturave.
- EN 13813: 2002 Materialet niveluese dhe niveluesat e dyshemeve - pajisjet e kerkuara.
- CEN. Perdorimi i konceptit te familjeve te betonit per prodhimin dhe kontrollin e pershtatjes se betonit. Raporti 13901.
- EN 12350 Tesimi i betonit te sapopergatitur .
- EN 12390 Testimi i betonit te ngurtesuar.
- EN 12504 Testimi i betonit ne struktura.
- EN 197-1: 2000 Cimento – Pjesa 1 : Perberja , Specifikimet dhe Kriteret e Pershtatjes per cimenton e zakonshme.
- EN 934-2: 2001 Shtesat e betonit ,llacit dhe finos – Pjesa 2: Shtesat e betonit – Percaktimet , kerkesat ,pershtatja marka dhe emertimi.

4.1.2 Cimentot

Cimento Portland (CEI), Cimento portland e perbere (CEII), Cimento me mbetje nga furnaltat (CEIII),Cimento Puzolane (CEIV) te specifikuara sipas Eurokodit EN 197 duhet te pajtohen me rregulloren EN 197 pjesa 1 deri 3.

4.1.3 Inertet e Betonit

Te gjitha inertet e betonit duhet te perftohen nga burime te aprovuara nga Supervizori. Mostrat e inerteve te trashe dhe te imet duhet te specifikohen dhe te kerkohen perpara se porositesi kryesor te vendose per cilesine dhe llojin, ose te udhezuar nga supervizori per te vendosur per pershtatshmerine e tyre sipas Supervizorit. Inertet nuk duhet te kene perberes te demshem ne sasi te tilla qe mund te jene te demshme per qendrushmerine e betonit ose te shkaktojne korozionin e armatures.

Diametri nominal maksimal i inerteve nuk duhet te kaloje 30 mm, si rrjedhim diametri maksimal i inerteve duhet te permbushe te dhenat e meposhtme:

- Nje e katerta e dimensioneve te vogla te pjeses struktureore;
- Distanca ndermjete shufrave te celikut te jete me pak se 5 mm, vetem ne rast se masa paraprake jane ndermarre, psh grupimi i shufrave te celikut.
- 1.3 here trashesia e betonit

Perdorimi i Mbushesve ne beton duhet te jete konform te gjitha aspekteve te kerkuara nga B.S. 882,1201 – “Inertet nga burime natyrore per betonet (perfshijne granilin)”dhe si rrjedhim kriteret

specifike të mëposhtme të testuara duhet të aplikohen në përputhje me B.S 812 "Metodat për marrjen të mostrave dhe testimi i mineraleve mbushes, reres dhe inerteve të tjere", pjesë 1 deri në 4. Inertët nuk duhet të përmbajne ndonjë material të cilët krijojnë reaksione të demshme me alkalet në cimento, ose ndonjë alkal tjetër i cili mund të jetë i pranishëm në inerte dhe ujë perzieres në shumën e mjaftueshme për të shkaktuar zgjerimin e betonit ose llacit. Duhet një analizë e mbushesve sipas ASTM C289 "Metoda standarte e testimit për reagimin e mbushesve (metoda kimike)" ose sipas ASTM C 295 "Praktika e Rekomanduar Standarte për ekzaminimet petrografike të inerteve të betonit" të tregojë që ndonjë përberës guri jep reaksion të demshëm dhe si rrjedhim inertët përberës të tilla nuk do të lejohen të përdoren në Punimet e Përhershme.

Inertët e trashë për beton dhe qelime të tjera do të jenë si zhavorri ashtu gure të thyer me diametrim të kërkuar.

Zhavorri natyror duhet të jetë i lirë nga dherat, balta, lymrat, argjilat, shistet argjilore ose gure të shpërbere, lende organike ose papastërti të tjera dhe ai duhet të jetë i ashpër dhe kokërr trashë. Guret me të mëdhenj dhe ato me të vegjël për jashtë diametrit të kërkuar duhet të hiqen dhe të mos përdoren në Punimet e Përhershme.

